

REPUBLICA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

Dërgues: Kuvendi Nr. 1251/4 Prot. Data.

11.11.2025

Shkurtimi i lëndës:

Deri për 2025

//Për trajtim nga;	
(struktura të tjera të ngarkuara)	
Me porosi:	

Për, të organizatave
për për masat
në të
revelatit

Afati: ☐ Normal (7 ditë) ☐ Prioritet (3 ditë) ☐ Urgjent (brenda ditës) ☐ Pa afat/për dijeni
Tjetër _____ ditë

Data 13.11.2025
Nenshkrimi:(TITULLARI)

Nr.Prot. 253/3

Marrë në dorëzim: 13.11.2025

Nënshkrimi Deri

Kalon për trajtim (struktura): DHASTY E Bylykchash

Me porosinë: Te ngarkohet për punën: E Bashkë E Bylykchash, O. Kumbullaj
A. Joso, L. Jelo, M. Spaho, S. Rendi, për trajtimin e plotë për zbatimin e

Marrë në dorëzim: komandimet Nënshkrimi Deri

Kalon për trajtim (struktura): E. Bylykchash

Me porosinë: Joso

Marrë në dorëzim: _____

Nënshkrimi _____

Kalon për trajtim (struktura): _____

Me porosinë: _____

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____

Specialisti

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____


Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____

Eprori në shkallë hierarkike

Trajtimi i materialit përfunduar më: _____

Eprori në shkallë hierarkike



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SHËRBIMI LEGJISLATIV
SHËRBIMI JURIDIK

Nr. 1251 / Prot.

Tiranë, më 11.11.2025

Lënda: Dërgim rezolute

INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Tiranë

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Rezolutë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2024”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Genci GJONCAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

Niko PELESHI

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË
TË DREJTËSISË PËR VITIN 2024

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruar në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe ministrin e Drejtësisë në kuadrin e inspektimeve tematike dhe përmbushjes së detyrave të tjera funksionale;

Vlerëson veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2024 në këto drejtime:

Praktikën për të zhvilluar një proces konsultimi ndërinstitutional lidhur me përzgjedhjen e tematikave të inspektimeve, duke garantuar përfshirjen e aktorëve të ndryshëm institucionale dhe shoqërisë civile, me gjithë mungesën e angazhimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë në këtë proces.

Krijimin e mekanizmit të dedikuar për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, i cili përfshin kërkesa për informacion të adresuara institucioneve të inspektuara pas përfundimit të afatit të zbatimit të rekomandimeve, dhe analizë të përgjigjeve nga institucionet përkatëse nga ana e grupeve të inspektimit.

Rritjen e numrit dhe kompleksitetin e hetimeve, përfshirë rastet e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë, përmes dhe bashkëpunimit me ILDKPI-në dhe institucionet e tjera, e cila ka forcuar standardet e llogaridhënies.

Transparencën institucionale dhe qasjen e hapur ndaj qytetarëve përmes komunikimit publik, asistencës dhe aksesit në informacion, edukimi ligjor si domosdoshmëri për rritjen e besimit te drejtësia.

Kuvendi rekomandon që Inspektori i Lartë i Drejtësisë për vitin 2025 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të hartojë një format periodik të raportimit për zbatimin e rekomandimeve të inspektimeve, me tregues të matshëm, përmirësime të identifikuara apo raste të përsëritura, për të forcuar ndikimin dhe efektivitetin e inspektimeve.

2. Të përfshijë inspektimet vijuese si pjesë të planifikimit vjetor të inspektimeve dhe të parashikojë burimet përkatëse për realizimin e tyre për të siguruar verifikim të drejtpërdrejtë të zbatimit të rekomandimeve dhe analizë krahasuese ndër vite.

3. Të iniciojë një protokoll bashkëpunimi ndërinstitucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme për të mundësuar akses në sistemet elektronike të gjykatave dhe prokurorive.

4. Të zhvillojë konsultime me Dhomën Kombëtare të Avokatisë, me qëllim identifikimin e problematikave në sistemin e drejtësisë dhe adresimin e tyre përmes inspektimeve tematike.

5. Të marrë masa për krijimin një sistemi për menaxhimin e çështjeve të ILD-së, me qëllim që të digjitalizojë proceset e shqyrtimit të ankesave, të verifikimit dhe hetimit, për të përmirësuar eficiencën, reduktuar vonesat dhe ndihmuar në ndjekjen në kohë reale të ankesave, hetimeve dhe inspektimeve, por dhe transparencën me qytetarët.

6. Të hartojë raporte analitike periodike mbi tematikat e ankesave të qytetarëve, me qëllim identifikimin e prirjeve kryesore të problematikave të evidentuara nga publiku, institucionet dhe identifikimin e çështjeve për inspektime tematike.

7. Të zgjerojë dhe forcojë veprimtarinë ndërgjegjësuere të komunikimit institucional përmes fushatave tematike dhe përmbajtjeve edukative të përshtatura për publikun e gjerë. Këto nisma të synojnë rritjen e njohjes së të drejtave të qytetarëve dhe rolit të ILD-së, duke përmirësuar ndërveprimin qytetar-institucion dhe duke rritur besimin te mekanizmat e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

8. Të përgatitet deri në dhjetor 2025 një analizë përgjithësuese për inspektimet e kryera në periudhën 2020 - 2025; përputhshmërinë e tyre me prioritetet e përcaktuara nga vet sistemi, ashtu dhe nga pritshmëritë e qytetarëve gjatë kësaj periudhe; efektin e krijuar në sistem dhe në besimin e qytetarëve te drejtësia; problematikat e konstatuara; bashkëpunimin me institucionet e drejtësisë dhe ato të lidhura me procesin; si dhe nevojat për mbështetjen e veprimtarisë së institucionit në të ardhmen.

Miratuar në datën 30.10.2025